

J E H O N A

Revistë dyjavore informative, politike dhe kulturore

www.revistajehona.com

Viti VIII. Nr. 106, (30 shtator 2015), çmimi 50 din.

ISSN 2334-8461 COBISS 47435015

ISSN 2334-8461



Komenti: VJESHTA POLITIKE



VITI I RI SHKOLLOR ME TELASHE TË VJETRA

MUHAMET XHEMAJLI



KOMANDANT-RREBEL

JHONA



Jehona

Revistë për kulturë, politikë dhe informim

Drejtor:

Zaim Haliti

Kryeredaktor:

Nexhmedin Saqipi

Redaksia:

Dr. Abdullah Hamiti, Dr. Llukman Halili,
Dr. Ferid Selimi, Nehat Salihu,
Muhamet Jashari, Mentor Haliti,
Mevlude Abdullahu

Lektor:

Begzad Abdullahu

Përpunimi kompjuterik dhe dizajni:

Kastriot Sinani

tel:

049-124101, 063-402336

e-maili:

jehona2013@live.com

E regjistruar me numër të vendimit

APR: 185/2013

Xh. I. në dinarë: 200-2701970101925-66,
Banka Postare Kursimtare AD,
17520 Bujanoc

ISSN 2334-8461

COBISS 47435015

Shtypet në shtypshkronjën:

"Grafos Print", Rr. "Aradhat Preshevare"
nr. 9, Preshevë

Përfaqësia e "Jehonës", në Zvicër
afër Zofingenit,
Skender Isufi, Adr. Graben, str.1,
4663 Arburg, 062/7970674

VJESHTA POLITIKE

Kemi hyrë në vjeshtë, në njëren nga katër stinët më të bukura të vitit. Stina e vjeshtës, në hemisferën veriore fillon, më 23 shtator dhe mbaron më 21 dhjetor.

Vjeshta, kjo stinë e bukur, e cila natyrës i jep ngjyrën e bukur prej ari, po ashtu na sjell një mot jo shumë të mirë.

Gjatë stinës së vjeshtës, dita bëhet më e shkurtër edhe pse ajo shpesh është e ngrohtë dhe me diell, pa përjashtuar të reshurat dhe uljen e temperaturave.

Vjeshta, në Luginë të Preshevës, vjen e shoqëruar, jo vetëm me ndryshime klimatike, por edhe me një mori aktivitete në fusha të ndryshme të veprimtarisë shoqërore dhe kombëtare.

Fillimi i vitit të ri shkollor 2015/2016, është një nga aktivitetet vjeshtore, i cili po përcillet me telashe të vjetra. Edhe më tej nxënësit e kësaj Lugine, përballesh me probleme të shumta sa i përket furnizimit me tekste shkollore. Përkundër dëshirës së madhe të lidershit shqiptar dhe Ministrisë së Arsimit të Kosovës, që këtë vit, nxënësi të furnizohen me tekste mësimore, mjerisht një kamion me libra, qëndrojnë në pikën kufitare të bllokuar nga embargoja e Beogradit. Vjeshta politike ka politizuar tejmas shkollat me drejtor dhe quadro partiake.

Këtë problem të ndjeshëm në fushën e arsimit nuk po mund ta zgjidh as Asociacioni i komunave me shumicë shqiptare në Serbi, e cila këto ditë vjeshtore u themelua, në Preshevë.

Vjeshta shqiptare në Luginë, po përcillet edhe një fluks të madh të emigrantësh nga Lindja e Mesme, të cilët po kalojnë nëpër Preshevë dhe Bujanoc, për të ikur për Evropë.

Vjeshta ka edhe gëzimin e nisjes së haxhilerëve për në vendet e shenja dhe kremtimin e Festës së Kurban Bajramit.

Vjeshta, në Luginë, do të ketë edhe surpriza të reja për shqiptarët e këtij rajoni, të cilët këtë stinë e shfrytëzojnë për vjeljen e të mirave vjeshtore, për tu përgatitur për stinën e bardhë, që në kalendarin vjetor njihet si stina e dimrit.

Redaksia

THEMELOHET ASOCIACIONI I KOMUNAVE SHQIPTARE NË SERBI

Këshilltarët komunalë të tri komunave Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë, kanë miratuar me unanimitet themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Shqiptare të Luginës së Preshevës.

Në mbledhjen e përbashkët të këshilltarëve komunalë ishin të pranishëm 43 këshilltarë, ndërsa mbledhjen e bojkotuan dy partitë opozitare Partia për Veprim Demokratik e Riza Halimit dhe Unioni Demokratik Shqiptar i Ramiz Zylfiut.

Drejtuesit e partive shqiptare në Luginë akuzuan pushtetin serb se nuk ka bërë asgjë për zgjidhjen e problemeve të shqiptarëve të Luginës, madje me dhunë dhe terror kanë tentuar të largojnë shqiptarët nga Lugina e Preshevës.

Kryetari i Komunës së Preshevës Ragmi Mustafa tha para këshilltarëve komunalë të Luginës se sot është ditë historike, sepse këshilltarët komunal të kuvendeve të tri komunave me shumicë shqiptare kanë mbështetur miratimin e një vendimi historik, i cili hap rrugë proceseve politike jo vetëm në Luginë, por edhe në Kosovë, Shqipëri, Evropë dhe instanca tjera ndërkombëtare.

“ Është një parim i reciprocitetit dhe logjikës së shëndosh për të cilën padyshim as kori diplomatik ndërkombëtar asnjëherë nuk ka mundur të thotë jo se atje meritojnë serbët të ngritën në nivelin me të lartë të drejtave të tyre në Kosovë, ndërsa ju në Preshevë duhet të mbeteni në shkallë me të ulët të të drejtave



elementare, si individuale po ashtu edhe kolektive”, tha Mustafa.

Më i ashpër në qëndrime ishte kryetari i Këshillit Nacional Shqiptar Jonuz Musliu, sipas të cilit qëllimi kryesor i Serbisë ka qenë pastrimi etnik dhe marrja e tokave shqiptare.

“Për këto përpjekje, populli është i vetëdijshëm, sepse rrugë tjetër nuk ka, formë tjetër nuk ka, përpos zgjidhjes së problemit politik, ajo është bazament për zgjidhjen e problemit të shqiptarëve...ky akt, ky vendim, ky vullnet është i gjithë shqiptarëve. Nuk mund të themi se ndryshe jetojnë një pjesë e shqiptarëve, ndryshe jetojnë një pjesë tjetër. Sepse gjendja është e njëjtë për gjithë shqiptarët...Çdo liderë që ka ngritur simbolin kombëtar ka ftesë për gjyq, çka, ky shtet çdo herë mendohet me dhunë, me terror për t'i larguar shqiptarët nga Lugina, por jo, shqiptarët janë të vendosur të jetojnë këtu, sepse vend tjetër nuk kanë, tokë tjetër nuk kanë, ky është vendi i tyre’,

tha Musliu.

Musliu nuk la pa kritikuar edhe Bashkësinë Ndërkombëtare, për të cilën tha se nuk mund të funksionoj me dy standarde, ndryshe për serbët në Kosovë, e ndryshe për shqiptarët e Luginës.

Kryetari i Bashkimit Demokratik të Luginës (BDL) Skënder Destani, tha se partia e tij e mbështetë themelimin e Asociacionit, ndonëse ai personalisht është kundër themelimit të asociacioneve etnike. Madje, tha se është edhe kundër marrëveshjes së arritur në Bruksel nga përfaqësuesit e Prishtinës dhe Beogradit.

Ai ka kritikuar përcarjen e spektrit politik në Luginë, duke shprehur skepticizmin nëse do të mund të zbatohet ky vendim, nëse edhe këshilltarët e dy partive opozitare, PVD-së dhe UDSH-së nuk do t'i bashkohen këtij Asociacioni.

“Aprovimi i marrëveshjes në ▶

Bruksel mes Prishtinës dhe Beogradit dërgoi Luginën që në reciprocitet të realizojnë një të drejtë të tyre ashtu siç do ta realizojnë edhe serbët e Kosovës. Po e shoh sot se në këtë Kuvend nuk janë të gjithë këshilltarët shqiptarë që për BDL-në është e papranueshme, sepse mendojmë që asociacioni është dashur, apo vendimi për themelimin e këtij asociacioni të sillet me konsensus dhe jo të përçahet sepse dyshojmë në implementimin e këtij vendimi, nëse edhe në të ardhmen do jemi të përçarë”, tha Destani.

Kryetari i Komunës së Bujanocit Nagip Arifi tha se propozim drafti për themelimin e Asociacionit është i bazuar në të drejtën universale për të drejtat e njeriut që është miratuar qysh në vitin 1948, në përputhje me referendumin e vitit 1992 dhe

marrëveshjen e Konçulit të viti 2001. Ai shtoi tha se themelimi i Asociacionit erdhi pas marrëveshjes së fundit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, ku serbët e Kosovës do të themelojnë Asociacionin e tyre.

“Tash pas marrëveshjes së fundit të Qeverisë së Serbisë dhe Qeverisë së Kosovës erdhëm në përfundim se deh ne shqiptarët duhet ta hartojmë një dokument i cili do të na shpie për një jetë me të mirë të shqiptarëve të Luginës. theksoi Arifi.

Pas miratimit të vendimit për themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Shqiptare në Luginën e Preshevës, do të formohen edhe organet tjera, për të hartuar statutin e Asociacionit dhe të gjitha funksionet tjera.

Sidoqoftë, ky Asociacion po kundërshtohet nga Beogradi zyrtar.

Kryeministri i Serbisë, Aleksandër Vuçiç, e ka quajtur veprim të papërgjegjshëm politik dhe të papranueshëm.

“Serbia di si të reagojë - me urtësi dhe mençuri. Nëse është e nevojshme ta tregojë fuqinë, mos keni dert, sepse gjithsesi do ta tregojë”, ka theksuar Vuçiç.

Ndërkaq, zëvendëskryeministri serb Ivica Daçiç, me tone të ashpra i ka porositur këshilltarët komunalë shqiptarë “të mos luajnë me zjarr”. “I paralajmërojmë që të shtunën në Preshevë të mos bëjnë ndonjë paralele me Bashkësinë e komunave serbe në Kosovë. I paralajmërojmë që të mos luajnë me zjarr dhe ta respektojnë kushtetutën dhe rendin e Serbisë”, ka thënë Daçiç.



BEOGRADI BLOKON LIBRAT SHQIP PËR NË PRESHEVË

Dy kamionë të mbushur me më shumë se 100 tekste shkollore në gjuhën shqipe, janë bllokuar në kufirin me Preshevën. Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Arsim Bajrami, më 10 shtator kishte bërë të ditur se MASHT-i ka filluar bashkëpunimin me ministrin e Arsimit të Serbisë, lidhur me tekstet shkollore për nxënësit shqiptarë që jetojnë në Preshevë, Medvegjë dhe Bujanoc. Në këmbim do të lejoheshin tekste të Serbisë për në zonat ku jeton dhe shkollohet komuniteti serb. Bajrami pati thënë se tekstet janë me kurikulë të re dhe absolutisht as nuk kanë gjuhë të urrejtjes, nuk kanë as përmbajtje ideologjike, janë tekstet të reja”, tha ministri. Por një kërkesë e tillë s’ka gjetur mirëkuptim.

“Çështja e Luginës, unë nuk çoj libra malit, unë çoj libra në mënyrë institucionale, jam ministër, ju kamë thënë se librat do i qoj në mënyrë zyrtare [në Preshevë]. Dy herë kam pasur takim me ministrin serb, librat i kamë dërguar në mënyrë zyrtare, kjo është konkluzion i qeverisë i juaji, më keni thënë vetë, dhe e kam bë. Kam shkuar vetë i kam përcjell librat sepse nuk lejoj me mu përdhosë librat dhe kam vendosur reciprocitet”, tha ministri.

Bajrami shtoi se kërkesa i ka ardhur prej qeverisë serbe që të lejohen librat serbë të shpërndahen në Kosovë. Për shkak të këtij bllokimi nga ana e autoriteteve serbe, ministri tha se si rrjedhojë ka urdhëruar të gjitha doganat e Kosovës që asnjë

libër serb nuk guxon të kalojë kufirin.

“Në mënyrë ligjore e kamë fjalën, malit nuk marr përgjegjësi, pa lejen time, deri sa libra në gjuhën shqipe nuk shkojnë në duar të nxënësve [në Preshevë]. Që 10 ditë dy kamionë me më shumë se 100 libra rrinë të parkuar në terminal, dhe unë paguaj 400 euro parking për ta dhe as nuk merren dhe as nuk procedohen, dhe unë i kam thënë ministrit serb në Split se unë do ta zbatoj reciprocitetin”, tha ministri i Arsimit të Kosovës. Bajrami tha se gjatë fillimit të javës së ardhshme do të shkojë në Bruksel, për të diskutuar për këtë çështje.

/kallxo.com/



APEL: TË MOS POLITIZOHET LËNDA FETARE

Koordinatori i lëndës fetare, Myftiu Nexhmedin ef. Saqipi, uron vitin e ri shkollor 2015/2016, duke u dëshiruar nxënësve dhe mësimeve të suksesshme në rrugën e edukimit, aftësimin dhe përparimin arsimor.

Myftiu Saqipi, apelon te institucionet komunale dhe ato arsimore, të heqin dorë nga ndikimet e tyre në politizimin e lëndës fetare dhe kuadrit të saj arsimor.

Në kuadër të këtij Apeli, Myftiu Saqipi, kërkon nga drejtorët e shkollave, që mos të manipulohen nga Listat jo adekuate të punëtorëve arsimorë të lëndës fetare, të

përpiluara dhe të manipuluar nga individë të papërgjegjshëm.

“Të mërkurën e ardhshme, më 9 shtator 2015, pritet që Ministria e Arsimit, të mbaj takim lidhur me këtë problematikë dhe t'ua dorëzoj me shkrim Listat me emra të kuadrit arsimor për lëndën fetare, nëpër shkollat me mësim në gjuhën shqipe”, thekson Myftiu Saqipi,

Myftiu Nexhmedin ef. Saqipi, fton përfaqësuesit e pushteteve lokale, pikërisht nga drejtoratet e Departamentit për Shërbime Publike dhe Veprimtari shoqërore, mos tu binden drejtorët e shkollave, që mësimeve të lëndës fetare



mos t'ia fillojnë procesin mësimor deri sa të vijë Lista përfundimtare, në mënyrë që ndërkohë të punojnë në favor të lëndës për shtimin e orëve të edukatës qytetare, për ta minimizuar lëndën fetare. E gjithë kjo bëhet që pushtetet lokale, t'i punësojnë militantët partiakë.

Myftiu Nexhmedin ef. Saqipi, ua bënë me dije se lënda fetare nuk është misionare, por informative. Punëtorët arsimorë, duhet t'i informojë dhe mësojnë për rolin dhe rëndësinë e lëndës fetare e jo t'i bindin ata të involvohen në proceset fetare. Lëndën fetare mund ta ndjekin edhe nxënësit, që i takojnë konfesioneve tjera, por që shprehin dëshirë për të mësuar për të mirat e fesë Islame, thuhet, midis tjerash në Apelin e Koordinatorit të lëndës fetare, të nënshkruar nga Myftiu Nexhmedin ef. Saqip.



NISEN HAXHILERËT E LUGINËS PËR NË HAXH

Bashkësia Islame për Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë (BIPBM), njofton opinionin me lajmin e mirë se sot haxhinjtë e Luginës së Preshevës, morën rrugën e Haxhit për Qabe.

BIPBM-ja, në bashkëpunim me Kompaninë “Mimoza”, nga Presheva, arritën me një angazhim maksimal të sigurojnë të gjitha kushtet për haxhilerët, të cilët me gëzim po marrin rrugën për në Haxh, për të përmbushur kushtin e pestë të Islamit.

Kryetari i BIPBM-së, Myftiu Nexhmedin ef. Saqipi, me këtë rast dha një mesazh urimi, duke u dëshiruar haxhilerëve rrugë të mbarë, shëndet e sukses në misionin e Haxhit, ndërsa të afërmeve të tyre gjithë te



mirat për festën e Kurban Bajramit. Gjithashtu, në mesazhin e tij, Myftiu Saqipi, i siguron qytetarët e Luginës, se në të ardhmen ata nuk do të përballen si dikur me vështirësi teknike rreth sigurimit të vizave dhe

dokumente të tjera përcjellëse për një rrugëtim të mbarë dhe të suksesshëm në Arabinë Saudite, përkatësisht në Meke, njofton Qendra për Informim e BIPBM-së.

BIPBM NDERON ME SHKUARJE GRATIS NË HAXH, NJË PJESËTAR TË NACIONALITETIT ROM

Myftiu i Luginës së Preshevës, Nexhmedin ef. Saqipi, në emër të Bashkësisë Islame për Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë BIPBM, këtë vit, ka vendosur që ta nderoj me shkuarjen në Haxh GRATIS, të Enver Dermakut, pjesëtar i nacionalitetit rom.

Enver Dermakut, është nipi i familjes së Shasivar Murtezi, emri i të cilit është i skalitur në pllakën përkujtimore së bashku me emrat e dëshmorëve të Tërnocit, të cilët gjatë vitit 1945, u ekzekutuan pa gjyq dhe nuk dihet ende ku janë ata të varrosur.



Vlen të theksohet se Myftiu Nexhmedin ef. Saqipi, është i pari në Ballkan, i cili ka qenë iniciator për

ndërtimin e Xhamisë për pjesëtarët e komunitetit rom, në Bujanoc.

Kjo shtëpi e Zotit, grumbullon besimtarët romë, të cilët i falin pesë vakte si dhe dëgjojnë ligjëratat fetare në gjuhën amtare.

E vlen, gjithashtu, të theksohet se nga viti 1997, Myftiu Nexhmedin ef. Saqipi, e ka ndihmuar komunitetin rom ta themelojnë Këshillin e Bashkësisë Islame Rome, njofton Qendra për Informim e BIPBM-së.

ZGJEDHJET NË MEDVEGJË

Rezultatet e fundit që kanë arritur në redaksinë e BujanociNet, nga zgjedhjet e mbajtura në Komunën e Medvegjës për formimin e organeve të pushtetit lokal, janë si në vijim: SNS - 3098, PD - 725, DS - 191, PVD - 465 dhe GG - 667 vota.

Siç shkruan portali Medvegja, në 28 vendvotime kanë votuar rreth 50 për qind e 10.460 qytetarëve me të drejt vote.

Në vendin e parë gjendet SNS Partia Përparimtare e Serbisë, e ndjekur nga Partia Demokratike në Medvegjë me 15 për qind të votave.

Nënkryetari i Partisë Përparimtare serbe (SNS), Nebojska Stefanović ka njoftuar sonte se lista zgjedhore "Aleksandar Vučić - SNS-SPS-PUPS" i ka fituar 60 për qind të votave në zgjedhjet lokale, apo 80 për qind të votave të serbëve.

Ai ka shtuar se lista tjetër zgjedhore, "Lista e qytetarëve", ka fituar rreth 13 për qind, Partia Demokratike (DS) ka fituar ndërmjet 3-4 për qind, kurse dy listat zgjedhore shqiptare kanë arritur përqindje të votave ndërmjet 24 dhe 25 për qind.

Ai po ashtu tha se numri i shqiptarëve është rritur nga ata që kanë arritur nga Kosova që sipas tij nuk jetojnë në Medvegjë, për çka "Serbia ka dështuar të bëjë listë të



dudur zgjedhore".

Sipas rezultateve të para jozyrtare të shtabit zgjedhorë të Partisë Demokratike, dega në Medvegjë, nga informatat e

grumbulluara nga komisionerët në vendvotime, kjo parti ka arritur që t'i ikë me rreth 230 vota Partisë për Veprim Demokratik. ./Telegrafi/



RRUGA E ZARBICËS GJALLËRON MALËSINË E BUJANOCIT



Hasan Sherifi, kryetar i Fondit Humanitar për Malësinë e Bujanocit, me qendër në Zvicër, thotë të jetë i kënaqur me mërgimtarët, por edhe qytetarët tjerë brenda Kosovës dhe në Kosovën Lindore, por edhe gjetiu, me faktin se iu janë përgjigjur, deri më tani, pozitivisht, kërkesës për të kontribuar në këtë Fond, me të cilat mjete parashihet kontributi që do të bëhet nga komuniteti në lartësinë e 30 përqindëshit, në realizimin e asfaltimit të rrugës Muhoc Zarbicë, që lidhë edhe fshatrat Çarr, Priboc, Suharnë, Novosellë dhe Ramabuqë dhe që vlerësohet me të drejtë një rrugë rëndësishme për

gjallërimin e kësaj ane.

Sherifi, i cili edhe vet është një kontributdhënës i mirë i këtij fondi, por që nga modestia nuk do të përmend shifra, se sa ka kontribuar, ka përgëzuar të gjithë ata që kanë ndihmuar deri më sot këtë fond, por ka ftuar edhe të tjerët t'i bashkohen kësaj iniciative, ta ndihmojnë Fondin Humanitar për Malësinë e Bujanocit, dhe ta jetësojnë sa më parë një rrugë të tillë.

Duke iu referuar të dhënave më të reja, por që ato mund të ndërrojnë në çdo qastë, pas dikush mund të ofrojë kontributin e tij në çdo

moment, ka thënë se deri më sot, në kontot e Fondit në Zvicër janë grumbulluar 94 mijë e 852 franga dhe 7 mijë e 384 euro, derisa në atë në Kosovë janë grumbulluar diku rreth 18 mijë euro.

Sherifi tha për Portalin 2L ONLINE, se i gëzohet faktit për besueshmërinë që kanë qytetarët në këtë Fond, dhe se si kryetar, ka ofruar transparencë maksimale. Sipas tij nuk lejohet kontributi në forma tjera, duke mos lejuar as pranimin e parave kesh në dorë, por vetëm duke i derdh mjetet në bankë nga kontributdhënësi, derisa përmes faqeve të ndryshme siç janë

edhe ato në rrjete sociale, bëhet publike në çdo moment, kontributi i secilit dhe gjendja momentale e fondit.

Sherifi thotë se kontributi i tij dhe i mërgimtarëve të tjerë për atë pjesë të Malësisë së Bujanocit, dhe tentativat për t'u organizuar edhe me banorët të asaj ane që jetojnë në Kosovë, përkatësisht në Gjilan, ka qenë i kamotshëm. Ai në këtë kontekst ka përmendur të ndjerin Nijazi Kadriun, me të cilin thotë të ketë pasur bashkëpunim të mirë në këtë drejtim, por shton se edhe me të tjerët po bëhet një punë e mirë duke paralajmëruar kështu që nuk do të ndalen vetëm në asfaltimin e rrugës MuhocZarbicë, por edhe me projekte të tjera.


Përndryshe, në bisedat e mëhershme me përfaqësues të komunës së Bujanocit, janë marrë



premtimet se komuna do të mbulojë 70 për qind të shumës sa do të kushtojë kjo rrugë në gjatësi diku 5.5 kilometra, derisa komunitetit i mbetet të i sigurojë 30 për qind. Në këtë drejtim duket se Fondit Humanitar për Malësinë e

Bujanocit po i shkon mirë, por se duhet akoma përkrahje që të sigurohen ato mjete dhe që ky mision të përmbushet sa më parë.

/2LONLINE/



“Zajednica” preshevare...

Kuvendi i këshilltarëve shqiptarë të Luginës së Preshevës, gjatë këtij vikend - shtatori, ka formuar Asociacionin e komunave shqiptare në Serbi.

Akti i themelimit të këtij Asociacioni, sa do që u quajt historik, ai, nuk zgjoi interesimin e faktorëve relevantë shqiptarë dhe ndërkombëtarë, për ta mbështetur e aq më pak për ta përgëzuar. Pse?

Sepse në këtë seancë kuvendore, nuk morën pjesë gati gjysma e këshilltarëve shqiptarë në opozitë. Nga Komuna e Medvegjës, nuk mori pjesë asnjë këshilltarë shqiptar, për shkak zgjedhjeve të jashtëzakonshme dhe mandatit të tyre të skaduar, kurse nga Komuna e Bujanocit, nuk morën pjesë gati gjysma e këshilltarëve shqiptarë opozitarë. Kështu nga 74 këshilltarë shqiptarë sa numërojnë kuvendet komunale të Luginës së Preshevës, vetëm 43 sish morën pjesë aktive. Në fakt për formimin e “zajednicës shqiptare”, ka votuar një komunë e gjysmë.

Përveç mungesës së unitetit të këshilltarëve shqiptarë dhe subjekteve politike, këtij Kuvendi, i ka munguar debati paraprijës publik, tribunat dhe bashkëpunimi me shoqërinë civile, bashkësinë fetare dhe faktorët e tjerë relevantë shqiptarë.

Po, Asociacionit të komunave shqiptare në Serbi, për shkak këtyre anomalive do t'i mungojë përkrahja dhe mbështetja institucionale të Tiranës, Prishtinës dhe ndërkombëtarëve.

Pse atëherë “Zajednica”?

Liderët institucionalë e partiakë të Luginës së Preshevës, ka

vite që vuajnë nga përçarjet, mosdurimi partiak, nepotizmi, lokalizmi, krahinizmi etj.

Lakmia për të qenë të parë, ka liderë i ka bërë servilë ndaj shtetit ku ata jetojnë dhe veprojnë. Në një komunë e gjysmë shqiptarë, sot kemi më shumë institucione se sa bajraktarë.

Në Bujanoc e ka selinë Këshilli Nacional dhe Trupi Koordinues, ndërsa në Preshevë mund të vendoset kreu i “Zajednicës” dhe pse mos të vihen në krye të saj Ragmi Mustafa?

Funksioni në katror

Nuk i takon moralisht, Jonuz Musliut, të jetë kryetar i “Zajednicës” edhe pse e ka merak dhe nuk do ta kundërshtonte, ngase është kryetar i Kuvendit Komunal të Bujanocit multietnik dhe kryetar i Këshillit Nacional Shqiptar. Po ashtu, nuk i takon as Nagip Arifit, i cili është

kryetar i Komunës së Bujanocit dhe nënkryetar i Trupit Koordinues.

Beogradi përmes këtyre funksioneve në katror, i kanë forcuar personalisht këta liderë politik, po nga ana tjetër

i ka shkatërruar nga brenda strukturat partiake, duke i ndarë në shumë krahë, klane dhe grupacione.

Meqë janë në prag zgjedhjet lokale në Serbi, akti i themelimit të “Zajednicës”, domosdo lidhet me propagandën parazgjedhore dhe reklamimet partiak, të cilave me të mëdha u ka rënë rejtingu.

Gabimet politike, mangësitë dhe defektet e tjera të qeverisjeve lokale, janë si pretekst i ngutjes së themelimit të “Zajednicës”, për t'i mbuluar humbjet, korrupsionin, nepotizmin etj.

Për ata që shohin më larg se hunda në politikë, aktin e themelimit të “zajednicës” e lidhin me shërbimet diplomatike të Beogradit, i cili edhe pse në parim e kundërshtoi, madje edhe e kërcënoi një akt të tillë, në heshtje po e zbrakon vëmendjen e opinionit nga “zajednica mitrovicase”, drejt “zajednicës preshevare”.

Humbësi më i madh nga këto lojëra pa kufij të lidershit shqiptar në Luginë, është populli i shumëvuajtur i kësaj Lugine, të cilët i ra hise të ketë mbi shpinë gjithë diskriminimit qindvjeçar të Beogradit e në kohë të fundit edhe të liderëve të saj, të cilët për interesa të ngushta personale janë në gjendje të shkelin mbi gjakun dhe djersën e qytetarëve, të cilët i shërbyen me votën e besimit e nga ajo fituan vetëm mjerim, skamje dhe sakrifica shpirtërore e fizike.



Arsyetimet e votuesve të “zajednicës” se “Në nenin e tretë të këtij vendimi Asociacioni i komunave me shumicë shqiptare të Luginës së Preshevës, do të ketë fuqinë e njëjtë juridike me Asociacionin e komunave me shumicë serbe në Republikën e Kosovës, duke u bazuar në parimin e reciprocitetit”.

Kjo është një rrenë e kulluar. “Zajednica preshevarë”, nuk e ka as fuqinë juridike e as politike të një reciprociteti, që nuk ekziston. Serbët e Kosovës janë kategori kushtetuese e Kosovë dhe gëzojnë një përkrahje të fuqishme nga Beogradi dhe faktorët ndërkombëtarë, ndërsa shqiptarët në Serbi janë pakicë kombëtare, minoritet, komunitet si romët, boshnjakët, hungarezët etj.

Jo vetëm kaq. Shqiptarët në Serbi, janë të fundit në hapësirat etnik, që akoma nuk e kanë të zgjidhur ligjërisht përdorimin e lirë të simboleve kombëtare, dygjuhësisë dhe integritet, ndonëse qe pesë vjet e kanë të formuar edhe Këshillin Nacional.

Copy paste

Liderët institucionalë të Luginës së Preshevës, janë imitues të keq të veprimeve të serbëve në Kosovë. Atyre u mungon origjinaliteti dhe pavarësia, por shkojnë copy past veprimeve të serbëve në Kosovë. Ky imitim i zbehtë i ka bërë këta liderë provincialë të shkojnë pas hapave të mëdhenjtë të liderëve serbë të Kosovës, të cilët e kanë bekimin e Beogradit, Prishtinës dhe Brukselit.

Është qesharake, madje cinike nëse “zajednica preshevarë”, krahasohet me “zajednicën serbe” në Kosovë. Deri sa liderët serbë në Kosovë predikonin rrugën jashtë institucionale të zgjidhjes së problemeve me protesta, bllokim të

rrugëve dhe krijimin e enklavave, liderët shqiptarë të Luginës krenoheshin me rrugën institucionale me mjete politike të zgjidhjes së problemeve në Serbi, duke marrë pjesë në të gjitha nivelet e zgjedhjeve dhe duke pranuar privilegje dhe ofiqe lokale dhe qendrore.

Edhe diçka, që nuk e keni ditur. Disa nga propaganduesit e “zajednicës” për shumë vjet rresht e kanë shfrytëzuar si kapital politik Referendumi e 1 dhe 2 mars 1992, për bashkëngjitje me Kosovën e më shumë kanë punuar për integrim në Serbi, pastaj janë betuar në vlerat e luftës dhe Marrëveshjen e Konçulit e kanë pranuar të bashkëqeverisin me ata, që deri dje i kanë masakruar dhe boshatisur nga trojet etnike, pastaj janë thirrur në Platformën e këshilltarëve shqiptarë të vitit 2006, për “definimin e Luginës së Preshevës si rajon i posaçëm politik, territorial dhe kushtetues, e në rast të mosrespektimit të parimeve të Grupit të Kontaktit dhe ndryshimit eventual të kufijve të Kosovës, do të angazhohen për bashkëngjitje të Luginës së Preshevës me Kosovën”.

Mutivoda

Një ditë pas themelimit të Asociacionit të komunave shqiptare në Serbi, më 13 shtator 2015, numër baksuz, ndodhën zgjedhjet e jashtëzakonshme në Komunën e Medvegjës.

Beogradi, ndonëse nuk veproi për ta bllokuar formimin e “zajednicës”, por në shenjë revanshizmi bllokoi depërtimin nga Kosova për në Medvegjë të votuesve. U desh të ngrihet në këmbë faktori institucional në Kosovë, Luginë dhe Bruksel, për t'i bindur autoritetet serbe, që zgjedhësve shqiptarët t'u lejohet e drejta kushtetuese e votës së lirë. Paramendoni, qytetarit nga

Medvegja me dokumente identifikimi e me të drejtë vote për shtatë orë rresht, iu pamundësua qarkullimi i lirë për në shtëpinë e tij. E përfaqësuesit e “zajednicës”, në Mutivodë, kufiri Kosovë Serbi, e panë efektin politik dhe fuqinë juridike, që ka dokumenti “historik”, të cilin e votuan me “Gëzuar!”.....

Se sa e duan shqiptarët Atdheun e tyre, u pa edhe gjatë procesit zgjedhor në Medvegjë, ata dolën me dy lista, ashtu të përçarë dhe të ndarë si gjithherë. E përçarja do të vazhdoj edhe pas zgjedhjeve, pas fitores së thellë të Vuçiqit, i cili edhe pse nuk ka nevojë për koalicione do t'i marrë në qeverisje këshilltarët e partisë së Nagip Arifit, duke lënë përfundimit në opozitë partinë e Riza Halimit, jo vetëm në Medvegjë, por në tërë Luginën. E medvegjasit, të katandisur si mos më keq, tashmë mund të numërohen në gishtërinj, për ditë pak e më pak, e që numri i tyre nuk e kalon 600 banorë nga 3000 sish sa kishte dikur. Sceptikët luten, që mos të ndodh Medvegja edhe në Bujanoc, mbase mund edhe të ndodh, hiç nuk i dihet...

Gjithçka mund të ndodh, në ditët e sodit, kur liderëve të Luginës së Preshevës, nuk u pret “sëpata në një vend”. Ata as sot nuk e kanë të qartë për çka angazhohen: për Autonomi, status special, asociacion, apo bashkëngjitje me Kosovën, apo jo?

Prandaj, nuk është çudi pse “zajednicën” nuk e pranojnë faktorët relevantë, për shkak joseriozitet të veprimeve, mosunitet dhe defekteve të tjera shumë të këqija për ardhmërinë e një Asociacioni, që mjerisht në hapat e parë të saj është e privuar të dështoj, ashtu siç kanë dështuar edhe shumë iniciativa të kësaj natyre.

Shoqëria Civile

“Perspektiva”, në Bujanoc

NË KUJTIM TË KOMANDANT REBELIT

Këshilli organizativ i fshatit Muhoc, shënoi përvjetorin e 10-të të vrasjes misterioze të Muhamet Xhemailit, i njohur në popull si Komandant Rebeli.

Në këtë manifestim përkujtimor, merrnin pjesë familjarë të dëshmorëve të kombit, veteranë të luftës UÇPMB-së, përfaqësues partiakë dhe nga fusha e shoqërisë civile, si dhe qytetarë të shumtë nga Malësia e Bujanocit, Presheva, Medvegja, Gjilani e Prizreni.

Manifestimi përkujtimor filloi me Himnin Kombëtar dhe me një minut heshtje kushtuar dëshmorëve të kombit.

Një fjalim të zgjeruar për jetën dhe veprimtarinë e Muhamet Xhemailit dhe trimave të tjerë të lirë e prezantoi kryetari i Këshillit organizativ, Vesel Sabedini, për ta vazhduar pastaj me fjalimet e ish ushtarëve dhe ushtarakëve të UÇPMB-së, familjarëve të dëshmorëve Arif Abazi nga Presheva, prindi i dëshmorit Artan Abazi, pastaj Milaim Elshani nga Malisheva e Kosovës, prindi i dëshmorit Agim Elshani, Gëzim Mazreku nga Gjilani, vëllai i dëshmorit Besim Mazreku, Haxhi Hyseni nga Tërnoci, prindi i dëshmorit Komandant Lleshi, Komandant Bala etj.

Me fjalimet e tyre komemorative u paraqitën edhe Avdil Ramadani, nënkryetar i Partisë Republikane, subjekt i vetëm politik, i cili mori pjesë aktive në organizimin e këtij përvjetori, pastaj Idriz Sinani, kryetar



i Forumit Ndërkombëtar i të drejtave të Njeriut me karakter ballkanik nga Kumanova, Selami Bajrami, kryetar i Bashkësisë Lokale nga Zarbinca, Shaban Shaqiri nga Muhoci etj.

Manifestimi përkujtimor kushtuar Komandant Rebelit dhe dëshmorëve të tjerë të çështjes kombëtare, u pasurua edhe me recital poezish nga poetja Rabije Bytyqi nga Prizreni dhe ▶

një grup nxënësish nga shkolla të ndryshme të Anamoravës.

Në fund të këtij manifestimi përkujtimor u lexuan nga organizatori telegrame dhe u vunë kurora në lapidarin e dëshmorëve.

Për dallim nga vitet e kaluara në këtë përvjetor, nuk mori pjesë bashkëshortja e Komandant Rebelit, Enkelejd Xhemaili dhe tre fëmijët e saj, ngase ka qenë e shtrënguar për shkak presioneve ta lëshoj vendin dhe të kërkoj strehë shpëtimi në perëndim. Pavarësisht nga braktisja e vendit zonja Enkelejda, nuk heq dorë për t'i zbuluar vrasësit kriminelë, të cilat, më 12 korrik 2005, vranë në pabesi burrin e saj Muhamet Xhemailin.

Malësia e Bujanocit, ditën e 12 korrikut e kujton me dhembje për vrasjen e Muhamet Xhemailit, ish Komandantit të Zonës Operative të Qarrit, i njohur si Komandant Rebeli.

Jo vetëm banorët e Malësisë së Bujanocit, por edhe më gjerë Muhamet Xhemailin e njihnin për komandat të rreptë dhe atdhetar të flaktë. Ai, ishte ndër komandantët e fundit, që i dorëzoi armët KFOR-it, në emër të paqes dhe stabilitetit rajonal.

Me të përfunduar konfliktet në Luginë të Preshevës, në vitin 2002, Muhamet Xhemaili zgjidhet këshilltar komunal në Bujanoc.

Tre vjet më vonë, pikërisht në vitin 2005, në Gjilan vritet në rrethana misterioze Muhamet Xhemaili, 47 vjeçar, i njohur si Komandant "Rebeli".

Për meritat luftarake dhe atdhetare, banorët e fshatit Muhoc,



komandantit të tyre i kanë ngritur një lapidar me emrat e tre dëshmorëve të kombit, të cilët i përkujtojnë tradicionalisht për çdo vjet. Muhoci, gjithashtu, në hyrje të Ambulancës së fshatit ka vënë pllakën përkujtimore për humanistin Doktor Ilazin, legjendën e Malësisë.

Këshilli Organizativ dhe disa nga oratorët e këtij manifestimi përkujtimor, kritikuan pushtetin lokal në Gjilan dhe Bujanoc, të cilët pak

kanë bërë për zbardhjen e vrasjes misterioze të Komandant Rebelit, si dhe dhanë një varg kritikash në adresë të institucioneve komunale, të cilat nuk morën pjesë në këtë manifestim përkujtimor, bile në njëfarë mënyre edhe tentuan ta pengojnë organizimin me moslejimin e ofrimit të karrigeve nga shkolla dhe shantazhe të tjera të natyrës politike.

/jehonapress/



ENKELEJD XHEMAILI NUK HEQ DORË PËR TË KAPUR VRASËSIT E BURRIT

Më 12 korrik 2005 është vrarë Muhamet Xhemaili i njohur si komandant Rebeli. Kanë kaluar 10 vite dhe familja e tij ende nuk ka asnjë lajm për hetimet që janë zhvilluar ose janë mbyllur rreth vrasjes misterioze të tij. Enkelejda Xhemaili gruaja e Rebelit thotë për rajonipress se pas 10 viteve është detyruar ta braktisë Kosovën për të jetuar diku në një shtet të perëndimit. Thotë se Kosovën e ka lëshuar për shkak të disa kërcënimeve. Edhe pse jemi larg ne asnjëherë nuk heqim dorë që vrasësit e burrit tim të dalin para drejtësisë shprehet ajo.



Enkelejda Xhemaili së bashku me fëmijët nuk e kanë të lehtë ta harrojnë datën e 12 korrikut 2005. Në këtë kohë Muhamet Xhemaili i njohur si komandant Rebeli do të vritet në mënyrë tinëzare në Gjilan. Ishte figurë kyçe e luftës së UÇPMB dhe ishte një lloj ikone e trimërisë që shfaqeshin nga djemtë e asaj ane. Vrasja e komandantit as nuk u hetua, por as nuk u zbardh kurrë. Dhe rëndom më së rëndi e përjetojnë familjarët, raporton rajonipress.

Tani gruaja e komandantit, Enkelejda Xhemaili së bashku me fëmijët janë detyruar ta braktisin Kosovën. Përvjetorin e 10 të vrasjes ata tani e presin diku në një shtet të perëndimit.

Enkelejda për rajonipress thotë se edhe pse janë bërë 10 vite nga vrasja rasti nuk është zgjidhur asnjëherë. “Nuk pati gatishmëri e as vullnet as nga policia e as nga prokuroria e

Gjilanit për ta hetuar rastin deri në fund. Pas kaq vitesh unë së bashku me fëmijët u detyruam që ta braktisim Kosovën për shkak të disa kërcënimeve që i kemi pasur. Nuk kishim siguri dhe nuk na ofroj askush siguri as nga Qeveria e Kosovës gjithashtu as nga Lugina e Preshevës nuk na kanë dhënë asnjëherë asnjë lloj statusi as të veteranit apo dëshmorit dhe ai akoma vazhdon të jetë i varrosur në varrezat e qytetit të Gjilanit” shprehet Enkelejda.

Enkelejda edhe pse larg Kosovës ajo asnjëherë nuk heq dorë nga ndjekja e atyre që ia shuan jetën komandantit të luftës. “Porosia ime është shumë e qartë. Ne si familjar asnjëherë nuk do të dorëzohemi. Kudo që do ndodhemi do të kërkojmë llogari për vrasësit” thotë ajo.

Enkelejda thotë se Muhamet Xhemaili dhe vepra e tij do të jetojnë gjithmonë në zemrat e shqiptarëve.

“Shumë shpejt do vij një ditë kur kontributi i Muhametit dhe meritat e tij do të vihen në vendin e duhur sepse fatkeqësisht në gjithë këto vite që kanë kaluar në pushtet, në qeveri, në organizata të ndryshme qëndrojnë njerëz të korruptuar, njerëz pa vlera kombëtare, njerëz që për interesa personale kanë harruar se këtë liri që e jetojnë e kanë falë gjakut të këtyre trimave, ushtarëve, komandantëve e heronjve që nuk u dorëzuan asnjëherë në betejat e hapura”.

Enkelejda thotë se ka shpresuar që përvjetori i 10 i komandant Rebelit ta gjejë më ndryshe, por pavarësisht këtyre katrahurave unë jam krenare për fëmijët e tu komandant, jam krenare për dashamiret e tu që të përkujtojmë me mall e me shumë dashuri së bashku edhe me djemtë Hedonin, Ramizin dhe vajzën Elonën” është shprehur Enkelejda.

/rajonipress/

STUDENTËT NGA LUGINA TË LIROHEN NGA PAGESAT E SEMESTRIT DHE OBLIGIMEVE TË TJERA

Shkruan:

Mr.Sc. Refik HASANI

Studentët nga rajoni i Luginës së Preshevës, duhet të lirohen nga pagesa e semestrit, vitit dhe pagesa tjera, por edhe në akomodimin në konvikte dhe sigurimin e shujtave në mensa të studentëve të këtyre universiteteve publike të jetë i rregulluar pa pagesë ose më një pagesë tepër të vogël simbolike. Kurse nëpër Universitete e kolegje private pagesa të jenë vetëm gjysma si në studime po ashtu edhe në konvikte dhe mensa për ushqim.

Dihet mirëfilli që për shumë vite është aplikuar njëanshëm taksa kufitare për shqiptarët nga Medvegja, Bujanoci dhe Presheva që kanë hyrë në Kosovë këto të hyra t'ju kthehen në njëfarë mënyre duke ju ndihmuar në investime në kuadro nga ajo pjesë. Po ashtu edhe Shqipëria ka obligim moral, Kombëtar e Kushtetues, të ngrisin dhe mbrojnë çështjen e shqiptarëve jashtë kufijve administrativë të Shqipërisë. Prandaj, studentët që regjistrohen nga tri komunat të lirohen fare nga pagesat për provime dhe semestër për Fakultete si për Studime.

- Themelore,
- Në MASTER dhe
- Në DOKTORATURË dhe specializime tjera.

Universiteteve publike të dy shteteve shqiptare i bien hise më së shumti të investojnë jo vetëm në shkollimin dhe arsimimin e kuadrove të kësaj Krahinë shqiptare por edhe në investime tjera. Studentëve nga këto Komuna duke ju mundësuar që sa më shumë të studiojnë nëpër këto Universitete publike përveç që do të ngriten në aspektin profesional shpenzimet do t'i kenë më të pakta dhe po aq me rëndësi do të punësohen në administratë pasi ende kemi mungesë të profileve në gjykatë, shëndetësi, Gjeodezi, Kadastër etj. Fryma shqiptare nuk mbrohet vetëm në Tiranë, Shkup e Prishtinë e gjetiu por edhe në çdo cep të Komunës së Preshevës, Medvegjës dhe Bujanocit dhe hapësirave tjera etnike shqiptare, prandaj lirim nga pagesa do të krijonte një motivim shtesë, një mbështetje morale.

Në këto tri Komuna të gjitha bibliotekat që janë të nivelit të shkollave e qyteteve të furnizohen dhe mbulohen nga buxhet e dy qeverive. Duhet të ndihmohet edhe në arkivat Komunale dhe arkivën Qendrore në Beograd, ku ka të dhëna shumë të vlefshme, jo vetëm për shqiptarët në këto tri komuna por nga e tërë ish-hapësira e Jugosllavisë së dikurshme. Këto tri komuna kanë nevojë për mbështetje financiare që të botohen libra e publikime që kanë të bëjnë me këto



tri komuna, për mbështetjen e ndonjë gazete apo reviste javore. Gjithashtu ne kemi disa Ansamble dhe Shoqëri Kulturore - artistike, që edhe këto do të duhej të mbështetën materialisht, sikurse edhe në investime në ruajtjen e objekteve dhe monumenteve kulturore-historike dhe vende të ndryshme të mirren ekspedita hulumtuese në Arkeologji e fusha tjera.

Presim që të fillojnë një qasje e re që Republika e Kosovës dhe ajo e Shqipërisë të ndërrojnë qëndrimin ndaj Krahinës së banuar me shumicë shqiptare të mbetur padrejtësisht nën administrimin e Serbisë.

SKENDER JUSUFI NJERIU, I CILI, PËR 24 VJET MBAJTI, BASHKË TËRNOCASIT

Jo më larg se këtë vit, në Tërnoc, takojmë veprimtarin e palodhur të Lëvizjes së Mërgimtarëve të Tërnocit (LMT) nga Zvicra, Skënder Jusufin, ish kryetarin e kësaj shoqate, i cili për 24 vjet rresht, i mbajti të bashkuar tërnocasit.

Misioni i LMT-së, nuk ishte vetëm, thjesht, humanitar për ta ndihmuar vendlindjen dhe viset e tjera etnike, por kishte edhe karakter kulturor dhe informativ. Përmes kësaj shoqate ruheshin me kultivoheshin, ruheshin dhe afirmoheshin, vlerat e kulturës shqiptare në diasporë, me një fjalë, mbrohej identiteti i shqiptarit jashtë vendlindjes.

Organizimi i manifestimeve të ndryshme kulturore me karakter shoqëror e kombëtarë, pastaj manifestimet sportive e organizimi i ndihmave për Tërnocin dhe vendet e tjera shqipfolëse, ishin prioritetet e Lëvizjes së Mërgimtarëve të Tërnocit, në krye të të cilës ka qëndruar për disa mandate Skender Jusufi.



Në maj, të këtij, viti patëm kënaqësinë të takojmë në Tërnoc, personazhin e rrëfimit për revistën “Jehona”, Skender Jusufin, i cili këtë revistë të vetme shqiptare, lidere të gazetarisë së shkruar në Luginë të Preshevës, e ka për zemër dhe e adhuron shumë.

Duke shpalosur kujtimet, jo vetëm për të kaluarën e LMT-së, revistës “Jehona” dhe shumë veprimtari të shumta me interes shoqëror e kombëtar, na del përpara portreti i Skender Jusufit, një veprimtar i papërkulur dhe i devotshëm i çështjes sonë kombëtare.

“LMT-ja ka qenë një shtëpi e jona e përbashkët, e cila u ka bërë konak shumë veprimtarëve politikë e shoqërorë, ka ndërmarrë shumë iniciativa për ta ndihmuar vendlindjen dhe gjithë ata, që kishin nevojë për ndihmë, ka bashkëpunuar me shoqata simotra, subjekte politike dhe institucionale, për t'i ecur përpara proceset demokratike, ka zhvilluar, kultivuar dhe promovuar vlerat kulturore e sportive, në diasporë, duke mbrojtur, kështu, identitetin kombëtar”, i thotë, mes tjerash, revistës “Jehona”, bashkëbiseduesi ynë Skënder Jusufi.

Në vazhdim, të bisedës, shkëputen kujtime të dashura dhe krenare, për aktivitetin e bashkëbiseduesit tanë, portreti i të cilët, është i njohur për shumëkënd, që e njohën dhe e patën rastin të veprojë me të.

“Jehona”, mëson se Skender Jusufi, ka lindur, më 10 qershor 1955, në Tërnoc të Bujanocit, Lugina e Preshevës. Shkollën fillore e ka kryer në vitin 1970 në vendlindje, kurse Gjimnazin, ▶

drejtimi Gjuhësor në Bujanoc, në vitin 1974. Në periudhën 1974-1979 ka studiuar në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës. Prej shtatorit të vitit 1981, kalon me punë në Zvicër.

Në periudhën 1981-1988, ka punuar si tekink dhe dirigjues i vinçit për firmat: “R.Stauffer AG” në Dietikon, “Leuthard AG” në Mereschwand.

Në periudhën 1989-1990, ka vijuar shkollimin njëvjeçar për përvetësim të mëtejshëm të gjuhës gjermane, kurse në periudhën 1990-1992 ka kryer shkollimin dyvjeçar në Qendrën Kantonale për Arsimim Profesional në Aarau dhe ka fituar titullin Teknik i lartë dhe Vizatues i ndërtimeve të larta.

Në vitin 1993 ka kryer shkollimin njëvjeçar për Informatikë në Qendrën Shkollore për Arsimim Profesional (CISAP) në Bernë dhe ka marrë titullin PC-Specialist, kurse në vitin 1984, në periudhën prej katër muajëve, ka kryer shkollimin për Këshilltar në lëmin e shitjes në “SMI” në Aarau. Prej vitit 1994 ka themeluar firmën e vetë “Ing. Büro Jusufi” në Oftringen ku ushtron veprimtari të pavarur në lëmin e planifikimit dhe renovimit të objekteve të



ndërtimeve të larta, dhe aktualisht po ashtu punon edhe për firmën “SCA Packaging” në Oftringen.

Gjithashtu, “Jehona”, mëson se Skender Jusufi, ka përvojë të mirë në lëmin e ndërtimeve të larta në Zvicër. Është autor dhe realizues i mbi dhjeta projekteve/objekteve në këtë lëmi. Është njëri prej themeluesve të shoqatës Lidhja e Mërgimtarëve të Tërnocit (LMT) në Zvicër dhe veprimtari dalluar. Aktualisht është kryetar i LMT-së. Po ashtu ka shpërblyer si këshilltar juridik dhe përkthyes për bashkatdhetarët tanë në Zvicër. Në periudhën 2001-2003 është zgjedhur këshilltarë i BISHZ-së. Aktualisht është këshilltar i

Shoqatës, udhëheqës i seksionit për çështje juridike, dhe kryetar i Komisionit statutar të Shoqatës.

Interesi i tij aktual është në zhvillimin e projekteve të vogla dhe të mesme në lëmin e objekteve të ndërtimeve të larta, dhënie e këshillave profesionale për shitje dhe blerje në këtë lëmi, këshilla juridike dhe përkthime.

Për fund, një si lajm, i mirë për adhuruesit e revistës “Jehona”. Kjo revistë kaq të dashur për Ju, në të ardhmen do të botohet me ndihmën e kush tjetër, pos Skender Jusufit, të cilit i falënderohet shumë.

SPEKTRI POLITIK SHQIPTAR PA PROGRAM DHE VIZION POLITIK

“Megapress” realizoi një intervistë me Belgzim Kamberin nga Këshlli për të Drejtat e Njeriut në Preshevë. Sipas Kamberit spektri politik shqiptar është sot substancialisht dhe strukturalisht i defaktorizuar. Pa program dhe vizion politik, ai është kryesisht i orientuar në realizimin e politikave klienteliste në dobi të interesave korruptive të individëve nëpër parti politike. “Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të njeriut në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë cenohen në një shkallë mjaft të lartë. Serbia nuk shfaq vullnet të mjaftueshëm politik për t'i avancuar të drejtat e pakicave kombëtare sikur komunitete.” thotë Kamberi

Megapress: Ju keni qenë kritik ndaj spektrit politik të partive shqiptare në Luginën e Preshevës, a mund të na tregoni arsyet?

Spektri politik shqiptar është sot substancialisht dhe strukturalisht i defaktorizuar. Pa program dhe vizion politik, ai është kryesisht i orientuar në realizimin e politikave klienteliste në dobi të interesave korruptive të individëve nëpër parti politike. Në fakt, spektri politik shqiptar përfitoj nga kjo gjendje shtypëse për të fshehur paaftësinë dhe abuzimet e saja. Përderisa në



njërin anë, Kushtetuta e Serbisë, si dhe legjislacioni, nuk mundësojnë avancimin e mjaftueshëm të të drejtave të komuniteteve joserbe në Serbi, në anën tjetër, papjekuria dhe paaftësia e spektrit politik shqiptar çdo ditë e më shumë, po kontribuon gjithashtu në tkurrjen e Luginës së Preshevës; si në aspektin territorial, ashtu edhe në atë demografik, socio-ekonomik dhe kulturor. Dështimet dhe skandalet e spektrit politik shqiptar të Luginës së Preshevës janë të

njëpasnjëshme, siç e dëshmojë së fundi çështja e lapidarit, ajo e regjistrimit të popullsisë, apo tani edhe vizita e Vuçiqit. Duke pasur parasysh presionin e shtetit serb dhe si rrjedhojë, mundësitë e kufizuara për organizim politik të qytetarëve « poshtë », sigurisht se një pjesë e përgjegjësive rëndon dhe « lartë », mbi Prishtinën dhe Tiranën zyrtare, të cilat nuk e përdorin autoritetin e tyre shtetëror, moral dhe kombëtar, si dhe nuk marrin përgjegjësitë e tyre; në

drejtim të përmirësimit të organizimit politik dhe të politikëbërjes shqiptare në Luginën e Preshevës.

Megapress: Si e konsideroni pozitën e shqiptarëve në Preshevë dhe në qytetet e tjera me shumicë shqiptare në Serbi?

Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të njeriut në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë cenohen në një shkallë mjaft të lartë. Serbia nuk shfaq vullnet të mjaftueshëm politik për t'i avancuar të drejtat e pakicave kombëtare sikur komunitete. Mbase i parandalon vazhdimisht duke përdorur të gjitha mjetet dhe mekanizmat e saj, qofshin ato edhe jologjore. Serbia zyrtare nuk shfaq interesim as për integrimin e shqiptarëve në Serbi, të shpallur si synim zyrtarisht nga politika lokale shqiptare; por përkundrazi, pas zyrtarizimit të djeshëm të deshqiptarizimit të Medvegjës; Serbia zyrtare është sot e orientuar drejt « rimarrjes » së Bujanocit nga serbët lokal, për ta shndërruar Preshevën si një ishull të izoluar drejt përmytjes së nesërme. E vlenë vetëm të analizohet Kushtetuta e Serbisë për të kuptuar se modeli i sotshëm shtetëror është realisht Serbia vetëm për serbët. Një model paramodern shtetëror që thëllon pabarazitë në të gjitha kontekstet dhe aspektet. Në Serbinë e sotme të Vuçiqit, vetëm metodat e shtypjes janë moderne. Ato maskohen me një diskurs paqësor « demokratik » dhe « evropian ». Shtypja e

dikurshme tradicionale serbe është zëvendësuar me format e « padukshme » bashkëkohore të shtypjes. Nën rrethim të « legjitimuar » ushtarakopolicor, me nënpërfaqësim sistemor dhe me mungesë të « arsytuar » investimesh e zhvillimi ekonomik; migrimi i « vetëvullnetshëm » ka zëvendësuar zhvendosjen e detyrueshme. Shuarja e dikurshme e dhunshme e rezistencës qytetare në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë është zëvendësuar tanimë me pasivizimin e tanishëm të saj, nëpërmjet korruptimit dhe shantazhimit të elitave lokale nga shteti. Serbia e Vuçiqit politikisht populliste, kulturalisht konservatore dhe ekonomikisht neoliberalë vetëm se përforcon regresin, diskriminimin dhe shtypjen tradicionale shtetërore serbe.

Megapress: A po respektohen liritë dhe të drejtat e shqiptarëve nga shumica serbe?

Serbia, ndonëse avancoon drejt Bashkimit Evropian, nuk po shfaq vullnet të mjaftueshëm politik për t'i avancuar realisht të drejtat e pakicave kombëtare sikur komunitete. Gjatë gjithë këtyre viteve të pluralizmit, Serbia vërtetoi se nuk dëshiron të shkëputet vërtetë nga tradita e saj regresive të nacionalizmit të saj hegjemonist. Pushtetari i vetëm serb i cili e filloi shkëputjen nga kjo traditë, Zoran Gjingjiqu, përfundoi i vrrarë nga vetë strukturat e shtetit serb. Serbia nuk

dëshiron të ndryshojë në këtë paradigmë. Ajo ka ndryshuar metodën, por jo përmbajtjen. Mjetin, por jo qëllimin. Imazhin, por jo shpirtëroren. Serbia e vërtetë simbolizohet sot më së miri përmes Luginës së Preshevës. Me metoda dhe mjete “paqësore dhe evropiane”, ajo ka për qëllim të sotshëm të forcohet politikisht, ekonomikisht dhe ushtarakisht; për t'i sunduar nesër përsëri të tjerët. Me këtë botëkuptim politik dominues tradicional; natyrisht se Presheva, Bujanoci dhe Medvegja, si rajon me shumicë shqiptare në Serbi; mbeten treva më e pazhvilluar, më e getoizuar dhe më e diskriminuar e shtetit serb, e ndoshta edhe e tërë rajonit; me shkallën më të lartë të papunësisë, e ku përfshirja e komunitetit shqiptar nëpër institucione shtetërore mbetet në shpërputhje drastike me strukturën demografike etnike shtetërore. Prandaj, Serbia duhet domosdoshmërisht ta ndryshoj Kushtetutën e saj duke e përshtatur me interesat e komuniteteve dhe rajoneve të marginalizuara dhe jo vetëm me interesat e partive dhe grupeve dominuese politike dhe shoqërore. Pastaj, Serbia duhet të fillojë më seriozisht të mendojë për modelet e rajonizimit dhe decentralizimeve që duhen zbatuar në vend.

/ Thekse nga një Intervistë më të zgjeruar të Megapress-it/

GJURMËT QË NUK SHLYHEN

(Bujanoci Burim i trashëgimisë sonë kulturore dhe natyrore)

Nga Arsim Halili

Këtë analizë po e filloj me një mendim “ Rrjedhimisht, të bëhesh pjesë e këtij shpirti të kohës është gjithnjë e më shumë se diçka e zakonshme. (Zeitgeist)

Njeriu i cili në vazhdimësi sjell risi krijuese, që do të mbesin gjurmë të shkruara e të dokumentuara me fakte e faktografi padyshim se është Xhemaludin Salihu. Ka disa vite që ka filluar angazhimet e tij institucionale në mbrojtje të Trashëgimisë kulturore materiale dhe jo materiale në këtë etnikum shqiptar. Përmes shoqatës për trashëgimi dhe krijimtari kulturore në Preshevë, ka arritur t'i materializoj, disa objektiva: qoftë përmes konferencave shkencore, hulumtimeve në terren dhe botimeve të kësaj natyre. Edhe pse në rrethana jo aq të lehta, duke i ditur kushtet objektive në të cilat jetojmë. Shihen se rezultatet nuk mungojnë. E gjitha ajo që do të ndalem është analiza e strukturës të njërës prej librave të botuar në vitin e kaluar, gjegjësisht 2014 i titulluar Bujanoci (Burim i trashëgimisë sonë kulturore dhe natyrore) autor Xhemaludin Salihu.



Struktura e këtij libri është si vijon: Parathënie nga ana autorit, hyrja, objektet dhe lokalitetet arkeologjike, objektet sakarale islame, objektet sakarale të krishtera, objektet e banimit dhe ndërtesa ndihmëse, objekte publike- shoqërore, përmendore lapidarë, pllaka përkujtimore dhe trashëgimia natyrore me gjithsej 244 faqe, botuar nga Shtëpia botuese “ Kurore“ Gjilan“ editor Hysen Kqiku. Duke qenë se në të kaluarën, madje edhe në ditët tona për qëllime krejt grabitqare, gllabërimit të kësaj hapësire shqiptare, pushtet pas pushteti synonin të përvetësonin si pronë kulturore e materiale të tyre. Përpjekja e tyre, gjoja se këtu nuk kanë ekzistuar asgjë nga të

parët tanë dardanët. Për shumë çka ia kanë arritur qëllimit qoftë edhe me dëshmi të fabrikuara, por që në interesin e tyre ishte edhe kjo formë. Sido që të jetë një ekip prej një numri simbolik nga Shoqata për trashëgimi dhe krijimtari kulturore në Preshevë në kryesimin e Xhemaludin Salihun, iu qasen punës së tyre për ti evidentuar dhe dokumentuar gjithçka që ka mundur t'i qëndroj dhëmbit të kohës në Bujanoc me vendbanimet tjera, duke përfshirë edhe fshatrat për rreth. Natyrisht se brenda mundësive të tyre trashëgiminë kulturore materiale dhe jo materiale me gjithë sfondin e pasur kanë has edhe në vështirësi siç janë : Mungesa e përkujdesit

institucional të shumicës prej objekteve qoftë kulturore, qoftë natyrore.

Shikuar nga ky prizëm duket se ky ekip ia del për së mbari në shumë çështje fal edhe bashkëpunimit të banorëve të cilët në memorien e tyre kanë të freskëta shumë gjëra . Vlen për tu cituar se gjatë hulumtimit në lokalitet të ndryshme të Bujanocit objektet të evidentuara dhe të dokumentuara me fakto grafi duke përfshirë edhe matjet gjeografike, duke i bërë matjet dhe koordinatat në mënyrën sa më të saktë, qoftë si lokalitete parahistorike, apo edhe ato antike janë: gjithsej dyzetë lokalitete të evidentuar në këtë libër. Nuk do mend se këtë hapësirë pa diskutim sesi në të gjitha hapësirat tjera shqiptare ka ekzistuar dhe ekziston toleranca ndërfaqetare.

Dëshmi e këtij gjenerim social ndër shekuj e vite të dieversiteteve etno- kulture janë edhe ekzistimi i kulteve pavarësisht se cilit besim i takojnë, apo cilit komb. Objektet edhe lokalitetet që janë evidentuar brenda librit në fjalë, si e tillë kjo pasuri kulturore vetëm se ia shton kredon e qytetërimit të lashtë deri në ditët e sotme. Brenda librit në fjalë janë evidentuar pesëdhjetë e një objekte fetare, disa prej tyre ekzistuese: xhamia, kisha, teqe, manastire e disa prej tyre natyrisht dhëmbi i kohës i ka shkatërruar. Gjurmët se në këto



lokalitet kanë qenë të banuar nga të parët tanë dardanët mbështet pikërisht nga këto objekte të kultit. Një kujdes të veçantë autori me ekipin e tij padyshim i vë edhe dokumentimi e atyre lokaliteteve ku të parët tanë prehen në

përjetësi e që evidentohen tridhjetë lokalitet të varrezave të cilat shumë prej tyre janë edhe qindra vjeçare duke e dëshmuar këtë edhe me shkrim osmano-arab, disalokalitet të këtyre varrezave janë brenda teqeve të



komunitetit bektashianë. Janë evidentuar edhe disa nekropole të ritit krishterë, ose edhe bizantin, kryesisht në tre lokalitet shqiptare aktualisht Tërnoc dhe Bilaç dhe Osllarë.

Një vëmendje të veçantë autori ia kushton edhe arkitekturës së banimit të kësaj hapësire dhe në këtë rast ndalet kryesisht të objektet e banimit familjar dhe objekteve përcjellëse të tyre, të banimit kolektiv (haneve bujtinave), të objekteve të rëndësisë shoqërore etj. Duhet theksuar se autori këtë rast me ekipin tij evidenton jo vetëm objektet të banimit dhe objektet përcjellëse të tyre, vetëm të popullatës shqiptare por edhe serbe, qoftë në vendbanime me ato vendbanime me popullatë heterogjene, apo edhe homogjene. Janë gjithsejtë njëzetë e katër objekte të banimit dhe objekteve përcjellëse. Ajo që duhet theksuar të gjitha këtë evidentime të këtyre objekteve janë mbi një qind vjet, disa të mbrojtura me ligj e disa të pambrojtura.

Objektet e rëndësisë shoqërore (objekte komunale, shkolla te reja e të vjetra, mejtepe , objekte doganore dhe hane janë evidentuara gjithsejtë pesëmbëdhjetë të kësaj kategorie. Duke qenë se dikur edhe buka edhe uji siguroheshin në forma klasike, megjithatë sot ato objekte si mullinjtë me ujë dhe çezmat disa janë funksionale e disa kanë mbet dekor natyror, autori për të



tilla objektet shkon cep më cep të kësaj komune për të t'i evidentuar dhe për të treguar atë pjesëhistorike të këtyre mullinjve në këtë libër janë gjithsejtë njëzetë e shtatë mullinj klasik me ujë dhe dhjetë çezma e puse uji të një kohe relativisht disavjeçare. Ajo që mbetet pjesë e historisë, pa dyshim janë edhe lapidarët dhe pllakat dhe në këtë rast edhe Bujanoci me rrethinë dëshmon se edhe në këtë anë u bë përpjekje për liri, sidomos fundshekullin e kaluar dhe fillim shekullin e tanishëm. Andaj për të gjithë lexuesit e këtij libri autori tregon se ku ndodhen ato vend ngjarje që u ngritën me respekt për të rënë lapidarë dhe pllaka përkujtimore. Të tilla ngjarje do të kujtohen edhe shumë breza pas nesh.

Autori i evidenton në këtë libër katërmbëdhjetë objekte të kësaj natyre. Ndonëse shumë kush edhe mund të mos e kuptoj drejt rëndësinë që gjenerojnë objektet e ndryshme natyrore, megjithatë

ata i qëndruan stuhive edhe natyrore, politike, sociale edhe kur u braktisën vendet qëndruan vertikal përballë çdo stuhie, siç janë lisat me peshë qëndravjeçare. Shumë prej tyre u ofrohen edhe mileniumit të parë siç thuhet në këtë libër për lisat e Turisë, rreth nëntëqind vjeçar. Si të tilla objekte të trashëgimisë natyre autori brenda këtij libri ka evidentuar njëzet lisa por edhe vendet ku edhe gjenden të tillë gjigantë në këtë hapësirë.

Nga sa u pa në gjithë këtë analizë përmbajtësore të këtij libri Bujanoci burim i trashëgimisë kulturore dhe natyrore, na jep të kuptojmë, se lexuesi ka arsye të njihet me këtë lokalitet, të mësoj atë që nuk e ka ditur deri në momentet kur e lexon këtë libër, pse jo edhe të shtohet interesim për të vizituar qoftë përn donjë mision të kësaj natyre, apo edhe ndonjë relaksim shpirtëror.



Poezi

ALFABETI I ARIFIT

Në Tërnoc, më të bukurin vend
Sa ka shqipja natyrale
Lind ideja e Arifit
Për një shpikje epokale

Kjo ide lind që moti
Jo më pak se dyzet vjet
Që shqiptarët më në fund
Të kenë vet një Alfabet

Alfabet me germa shqip
Jo si Ai i Manastirit
As i Fishtës e Stambollit
As i Mjedës Kristoforidhit

Mjaft ne mësuam e kënduam
Me do shkronja mbarë e prapë
Që tingëllonin me një stil
Grek, latin dhe arab

Udhë e shkronjave rrokulliset
Sipër maleve e mbi det
Vjen e ndalet te Arifi
Për të marrë një tjetër jetë

Sfidë e madhe për gjuhëtarë
Për shkollarë e shqiptarë
Qoftë me jetë ky Alfabet
Që na bënë kaq shumë krenarë

**Sarajevë, Bash Çarshi,
8 shtator 2015**



Poezia “Alfabeti i Arifit”, u shkrua në Sarajevë, bash në Bash Çarshi, gjatë një vizite miqësore, të organizuar në Klubin e shqiptarëve, më 8 shtator 2015.

Vargjet janë të motivuara nga libri “Alfabeti i mileniumit të ri”, të autorit Arif Osmani, nga Tërnoci, me punë të përkohshme në Zvicër. Ky libër me karakter Alfabeti, është një nga sfidat kryesore, që i bëhet albanologëve shqiptarë, kudo qofshin ata.

Për këtë zbulim epokal, në fushën e gjuhësisë shqiptare, Arif Osmanit, iu desh plot 40 vjet punë dhe angazhime, që bashkëkombësit e tij, më në fund, ta kenë alfabetin shqip, me shkronja, thjesht shqipe, e jo të huazuar nga alfabeti latin, grek e arab etj.

Porosia E Krasniqit Dhënë Medimut Në Preshevë Më 1996: “Të Bashkuar Do Të Fitojmë, Të Përçarë-Do Të Humbim”

Disa pjesë të intervistës së Akademik Mark Krasniqi dhënë Xhemaledin Salihut, drejtor dhe Sevdail Hysenit, gazetar i gazetës “VEPRIMI” në Preshevë, më 1996.

“...Por, për t'ia arritur qëllimit, të gjitha partitë dhe organizatat tjera shqiptare duhet ta kenë një qëllim madhor të përbashkët-lirinë dhe pavarësinë politike kombëtare. Nëse angazhohemi me gjithë potencialin që e kemi intelektual, shpirtëror dhe material për sendërtimin e idealit tonë kombëtar, që është ideal i ynë shekullor dhe e drejtë e jona natyrore, historike, juridike, etnike etjerë., siç e kanë arritur këtë të drejtë të gjithë popujt tjerë na Evropë e në Ballkan.”

“Mesazhi im lidhur me organizimin e pavarur politik të shqiptarëve në rajonin e Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës do të ishte: Uniteti, bashkimi i të gjitha forcave rreth idealit të përbashkët kombëtar. Këtë porosi do ta kisha jo vetëm për Kosovën Lindore, por për të gjithë shqiptarët kudo që janë, për të gjitha partitë, klubet e shoqatat tona.”



Akademik Mark KRASNIQI në bisedë me drejtorin dhe gazetarin e “VEPRIMIT”

“Zënkat e ndryshme, liderizmi, bajraktarizmi, interes e ngushta personale, uria “për pushtet”, për emër të madh etjerë, janë sëmundje të rrezikshme, të cilat e brejnë dhe e shkatërrojnë organizmin tonë politik, na bëjnë të merremi me vetveten dhe t'ia kthejmë shpinën idealit kombëtar.”

“Të bashkuar- do të fitojmë, të përçarë- do të humbim.”
“...Uroj që gazeta Juaj të luaj rol të rëndësishëm në jetën kulturore e politike të Kosovës Lindore. Uroj që ajo të ngjallë flakën e

ardhetarizmit të vërtetë në të gjitha zemrat shqiptare të kësaj treve, të ngjallë idenë e bashkimit dhe të sakrificave, të qëndresës dhe të përpjekjeve të vazhdueshme për sendërtimin e të drejtave politike e kombëtare edhe të kësaj pjese të Kosovës Martire.”

Përgatiti:

*Xhemaledin SALIHU-
Preshevë*

NJË RRUGËTIM PËR NË TIRANË

Është ditë e enjte e 4 shtatorit, ditë me diell, që nuk ta çon mallin se jemi në vjeshtë.

Stafi drejtues i Akademisë “Stoa”, i udhëhequr nga kryetari i saj, prof. Begzad Avdiu, talentet e reja, pastaj Halim Hasani, krijues letrar, anëtar i Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës dhe anëtar i Shoqatës së Shkrimtarëve “Feniksi” nga Presheva, kameramani i RTV “Bujanoci”, Blerim Hyseni dhe shoferi Agimi, u gjendën sipas marrëveshjes, në vendin e caktuar, përballë Xhamisë së qytetit, për të marrë rrugë për në Tiranë.

Gjatë rrugëtimit misionarët, kishin emocionie, ata me padurim prisnin të arrinin në shtetin amë në Shqipëri, me destinacion në Tiranë.

Në kryeqytetin e Shqipërisë, ata fillimisht vizituan Universitetin Europian të Tiranës, për tu takuar më pas me një krijues të madh, një figurë emblematike, një njeri me kulturë të lartë etike e akademike e, ai, ishte



Ylljet Aliçka, shkrimtar, për të zhvilluar një bisedë miqësore e poetike me të.

“Duke pritur shkrimtarin, befasia na doli përpara. Shkrimtari vinte me çikletë, me një pamje modeste, si qytetar i zakonshëm. Ai, na ofroi mirëseardhje me një ngrohtësi vëllazërore. Ky njeri nuk e paska rastësisht emrin Ylljet, vërtet na qenka një Yll i letrave shqipe”, i tha Prof. Begzad Avdiu, revistës “Jehona”.

Ylljet Aliçka, mes 10 shkrimtarëve më të mirë europianë

Europa mund të njihet më mirë përmes letërsisë. 10 shkrimtarë të njohur europianë do të bëhen pjesë e projektit ndërkombëtar të Bashkimit Europian “Net të letërsisë europiane 2012-2014”.

Shkrimtarët e përzgjedhur janë emra të njohur të letërsisë bashkëkohore nga vende si: Anglia,

Gjermania, Spanja, Franca, Republika Çeke, Irlanda. Këtij grupi të përzgjedhur me kujdes, i cili pritet të kthehet në një rrugëtim letrar, ku do të shkëmbehen eksperiencia dhe do të hidhen ide mbi atë çfarë letërsia reflekton sot, do t'i bashkëngjitet dhe shkrimtari shqiptar, Ylljet Aliçka. Ai është përzgjedhur si autori që do të përfaqësojë letërsinë shqipe në këtë eveniment. “10 shkrimtarë të njohur bashkëkohorë nga vende të ndryshme europiane, ardhur nga gjuhë e stile të ndryshme, nëpërmjet leximeve të tyre publike, si dhe veprimtarive të tjera promovuese do mundësojnë audiencën të udhëtojë nëpër Europë si dhe të njihet në një formë të re me vlerat e letërsisë së sotme europiane”, thuhet në komunikatën për shtyp të këtij aktiviteti.

Aliçka ka botuar librat “Parullat me gurë”, 2003, “Një rrëfenjë me ndërkombëtarë” 2006”. Librat e tij



PROF. DR. TONIN GJURAJ / REKTOR I UET

janë përkthyer në frëngjisht, polonisht, anglisht, italisht, e së fundi në gjuhën esperanto. Çmimin e parë Aliçka do ta merrte në një konkurs të tregimit ndërkombëtar në Itali më 2000-shin, më pas do të vlerësohej me çmimin e dytë në konkursin ndërkombëtar "Arts et Lettres de France", Francë, 2000; medalje bronzi nga "Academie Internationale de Lutece", Francë, 2001; "Penda e Argjendtë", në prozë, nga Ministria e Kulturës, Rinisë e Sporteve, 2001; çmimi i parë, si skenari më i mirë, "Festivali i filmit shqiptar", 2006, libri më i mirë artistik i vitit, "Akademia KULT", 2006.



Pak biografi

Ylljet Aliçka, ka lindur në Tiranë, më 23 qershor 1951. Ai, mban titullin Doktor i Shkencave dhe Profesor i asociuar. Ka kryer detyra shtetërore të rëndësishme si, drejtor i Marrëdhënieve me jashtë në MTKRS, si dhe është ambasador i Shqipërisë në Francë dhe Unesco.

Ylljet Aliçka është bashkëautor në 14 botime didaktike në shkencat natyrore, por ka botuar në shqip tregimet, "Kompromisi", "Parrulla dhe gurë", "Një rrëfenjë me ndërkombëtare" në vitin 2006, etj.

Aliçka u bë i njohur me skenarin e filmit "Parrullat", një prodhim franko-shqiptar, si dhe me filmin "Një ndodhi shqiptare", prodhim ky italo-franko-shqiptar.

Çmimet që ka fituar janë "Penda e argjendtë" nga MTKRS në vitin 2002, Medalje bronzi nga Akademia "International de Delutece", në Francë 2001, Çmimi i parë në prozë "Një rrëfenjë me ndërkombëtare", nga Akademia Kult 2007, etj./ch/

UET, ishull ekselence

Universiteti Europian i Tiranës është renditur si universiteti më i mirë ndër 34 universitete shtetërore dhe private në të vetmin vlerësim të kryer nga një kompani ndërkombëtare akreditimi si ajo gjermane CHE Ranking University

Falë reputacionit tonë të shkëlqyer në kërkimin shkencor, mësimdhënien dhe jetën e gjallë studentore, më shumë se 10,000 studentë kanë zgjedhur të studiojnë në UET. Ne mbështetemi në më shumë se tre mijë studentë të diplomuar të cilët sot punojnë në kompani private, institucione publike apo organizata jo fitimprurëse, duke çertifikuar cilësinë e studimeve në UET.

Bëhuni pjesë e UET!



Universiteti i Europian i Tiranës (UET) është një Universitet Privat i themeluar në vitin 2006, nga një grup prej 6 intelektualësh, ku përfshihen katër akademikët Adri Nurellari, Blendi Kajsio, Ermal Hasimja dhe Henri Çili, manaxheri Laert Duraj dhe gazetari Robert Rakiplari. UET-i është licencuar nga Ministria e Arsimit më datë 20 Shtator 2006 bazuar në vendimin e Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë Nr. 636, datë 20.09.2006. Në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 796, datë 22.07.2009, UETi, nga “Shkollë e Lartë Universitare” u strukturua ligjërisht në “Universitet” dhe është një institucion arsimor i akredituar nga Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë.

PËRURORHET KRIJIMTARIA LETRARE E MUSTAFË ISMAILI



Në Shtëpinë e Kulturës, në Bujanoc është bërë përrurimi i dy romaneve “Rruga pa adresë” dhe “Shtigjeve të natës”, si dhe një vëllim poetik “Monolog mërgimtari”, të shkrimtarit nga Samolica, Mustafë Ismaili, i cili jeton dhe vepron familjarisht në Toronto të Kanadasë.

Në këtë eveniment kulturor, merren pjesë përfaqësues nga jeta kulturore e institucionale të rajonit të Luginës së Preshevës dhe më gjerë, nën përkujdesjen e shoqatës “Guri i Zi”.

Për jetën dhe veprimtarinë letrare të Mustafë Ismailit, folën Sevdail Hyseni, Begzad Abdullahu dhe Flora Hyda.

Gjatë diskutimit të tyre u theksua se Mustafë Ismaili, qoftë në prozë e qoftë në poezi, e shpreh me ndjesi realitetin biografik të popullit t? tij. Në çdo vepër të botuar të shkrimtarit Mustafa, shtjellohet historia e jetës së tij, e vendlindjes për të cilën ndjen mall e dashuri.

Historia e personazheve të librave të Mustafë Ismaili, është e mbushur me plot rrëfime interesante nëpër të cilat ka kaluar familja e tij dhe populli shqiptar, të cilit i ra hise të përjetoj një nga torturat dhe masakrat më të tmerrshme, që njeh historia njerëzore, gjatë regjimit totalitar të Milosheviqit, thuhet në

njoftimin e shoqatës “Guri i Zi” në Bujanoc.

Në vazhdim të përrurimit të veprimtarisë së Mustafë Ismaili, një grup nxënësish nga Shkolla e Mesme “Sezai Surroi”, recituan fragmente nga romanet “Rruga pa adresë”, “Shtigjeve të natës”, si dhe nga vëllimi poetik “Monolog mërgimtari”.

Më pas në diskutime u përfshi edhe vetë shkrimtari Mustafë Ismaili, i cili nga zemra falënderoi të pranishmit, të cilët në mas kaq të madhe ia shtuan madhështinë këtij aktiviteti letrar.

Ai, në pika të shkurta tregoi për

veprimtarinë e tij jo vetëm letrare, duke u përgjigjur në shumë pyetje të shtruar nga publiku.

Në mesin e atyre, që u përfshinë në përgëzime dhe pyetje, kishte veteranë të arsimit, profesorë, krijues dhe drejtues institucionesh.

Historiku i shkrimtarit Mustafë Ismaili

Vlen të theksohet se Mustafë Ismaili, lindi, para 60 vitesh, pikërisht, më 7 mars të vitit 1955, në Samolicë të Bujanocit. Ai, shkollimin fillor të ciklit të ulët e mbaroi në fshatin e lindjes në Samolicë, për ta përfunduar tetëvjeçaren në Raincë të Preshevës, shkollimin e mesëm e filloi në Tërnoc dhe përfundoi në Gjymnazin “Skënderbeu” në Preshevë, ndërsa studimet i mbaroi në Fakultetin e Filologjisë, Letërsi dhe Gjuhë shqipe në Prishtinë.

Që nga viti 1981, Mustafë Ismaili, jetoi në Fushë Kosovë, duke filluar karrierën e mësimdhënësit të gjuhës shqipe në Shkollën Filllore “Selman Riza” dhe në Shkollën e Mesme të Bujqësisë në Prishtinë. Misionin e mësuesit e vazhdoi edhe në Zvicër te familjet e mërgimtarëve.

Përveç ushtrimit të misionit të mësuesisë, Mustafës, për shkaqe të rënda ekonomike, i ra hise të punoj edhe si punëtor krahu, në Zvicër, Gjermani dhe Francë.

Gjatë luftës së vitit 1999 në Kosovë, Mustafa ka të zhdukur anëtarë të familjes së tij, si dhe duke iu djegur në tërësi shtëpia.

Nga viti 1999, Mustafë Ismaili, jeton në Toronto të Kanadasë.

Në periudhën prej vitit 2002-2006, ka qenë nënkryetar i Komunitetit shqiptar në Kanada,

Shkrimtarëve “Arif Shala” në Vankuver të Kanadasë, anëtar i Shoqatës shqiptaro kanadeze në Toronto.

Aktualisht është pronar i Kompanisë “Euro Plumbing” në Toronto të Kanadasë, ku krijon dhe jeton familjarisht.

Deri tashti ka të publikuara



me angazhimet e tij janë hapur disa klasë në gjuhën shqipe për fëmijët e mërgimtarëve.

Me shkrime filloi të merret që herët. Ka bashkëpunuar si korrespondent me gazetën “Rilindja”, e “Tribuna shqiptare” me revistën “Zëri i rinisë”, ka qenë nënkryetar i Partisë Liberale të Kosovës, dega në Fushë Kosovë.

Është anëtar i Shoqatës së Shkrimtarëve “Feniks”, në Preshevë, “Atunis” në Kosovë, si dhe anëtar i Shoqatës së

këto vepra vëllimin poetik “Jeta ka një kahe”, pastaj romanet: “Rruga pa adresë”, të botuar nga Ndërmarrja Shërbyese “Jeta e re”, Prishtinë, në vitin 2013, “Shtigjeve të natës”, të botuar nga Shtëpia Botuese “Blini BK”, Gjakovë, në vitin 2014 dhe librin me poezi “Monolog mërgimtari”, të botuar nga Shtëpia Botuese “Meshari”, Prishtinë, në vitin 2015. Mustafë Ismaili, ka në dorëshkrim edhe vepra të tjera, që presin ta shohin dritën e botimit.

SHFAQET PREMIERA E FILMIT ARTISTIK “ROMANCA E HIDHUR”

Në Pallatin e Kulturës, në Bujanoc, të premten e 2 tetorit, u shfaq premiera e filmit të metrazhit të gjatë “Romanca e hidhur”, të regjisorit dhe skenaristit Valton Jakupi me stafin e tij të kinoproduksionit “International Europe London Swiss”.

Një pjesë e filmit “Romanca e hidhur” është realizuar në Zvicër, kurse pjesa tjetër në Bujanoc, duke angazhuar në këtë projekt filmik aktorë, kryesisht nga vendlindja e regjisorit Jakupi. Prandaj, nuk është aspak e Prandaj, nuk është aspak e çuditshme, pse Valton Jakupi, zgjodhi Bujanocin, për ta shfaqur premierën e filmit.

Para dhe gjatë shfaqjes së filmit “Romanca e hidhur”, sheshi i Bujanocit, ishte i stolitur me pllakata filmi dhe në ditën e shfaqjes së tij, u vërejtën shumë ardashës jo vetëm nga kjo komunë.

Regjisori dhe skenaristi i filmit “Romancë e hidhur”, Valton Jakupi, nuk është i panjohur për ardashësit e kinematografisë. Prandaj presin me padurim këtë projekt të tij të radhës. Shtojkësaj edhe kërshërinë që emri i Valtonit lidhet edhe me njërin nga projektet më të mëdha në historinë e kinematografisë shqiptare,



me filmin “Mbret i mbretërve”, i cili i kushtohet heroit legjendar Gjergj Kastriotit Skënderbeut, filmi cili do xhirohet nga regjisorët me famë ndërkombëtare të Hollywood-it, në mesin e të cilëve do jetë edhe Valton Jakupi.

Pas shfaqjes së parë të filmit në Bujanoc, ardashësit e kinematografisë do të kenë rastin ta shohin këtë film artistik në shumë qendra të Evropës, por edhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

PËRURORHET LIBRI ME POEZI “ENIGMË”, TË AUTORES YLLKA YMERI

Në bibliotekën Kombëtare në Prishtinë, më 30 shtator, u bë përrurimi i librit poetik “Enigmë”, të autores nga Tërnoci, Yllka Ymeri.

Botimi i këtij libri u mundësua nga British School, Prishtinë, nën përkujdesjen e Shtëpisë Botuese “Albasa” me recensentët: Behar Gjoka e Sali Bashota.

“Enigmë” titullohet përmbledhja e parë e Yllka R. Imerit, një tekst poetik, që mëton shpërfaqjen unit të poetes, me të gjithë dritëhijet dhe fibraturat e veta.

Librit strukturohet në tre cikle, Dashuri, Jetë dhe Parim, që mundëson zbuluesën e tre vatrave kryesore të frymimit kreativ, të një dëshmimi universal, të cilat janë qendër e shkrimit poetik në secilën fillesë të autorëve, të letrave shqipe dhe më gjerë. Si ndjesi më thelbësore, varësisht hapësirës së teksteve, është marrëdhënia me fjalën, e cila përgjithësisht vjen e shlireshme dhe e atypëratyshme, me vargun, që shqipton pentagramin e vargëzimit të lirë, duke endur një poetikë të subjektives dhe konkretes, pa shenjzime zbukurimore.

Poezia e Yllka Ymerit, në zgjedhjet tematike, në aparatit estetik, nuk rend pas figurës apo metaforës, jo se ato mungojnë plotësisht, por më tepër vrapon pas poezisë që thotë atë që ndjen, me mënyrën vetjake, duke ofruar një shans për të ndërë pulsën e poezisë së një breznie tjetër, që jeton realisht dhe artistikisht në mijëvjeçarit e ri. Më tepër se sa komenti mbi të, libri i parë



i autores, Enigmë, është një realitet që shijohet në lexim, është një shans për të uruar autoren: Udhë të mbarë në shtegtimin e letrave, ku fillimi është caku që të hedh në garën e ligjërimin si vlerë estetike, ku pak mbërrinjë, por fillimi i mbarë është shenjë mbarësie, thotë gjatë përrurimit recensenti Behar Gjoka.


Ndërkaq, autorja e librit “Enigmë”, Yllka Ymeri, thotë se “Libri brenda vetes përmban

filozofinë time, trillimin tim, dashurinë time, dhe mbi te gjitha jetën time. Jam munduar të shkruaj poezi që çdo kush kur t'i lexoj duhet t'i ndiej, të ikë nga bota reale dhe të futet në atë shpirtërore, t'i tejkalojnë kornizat kur ndienja është e pastër, për të bërë ndonjë gjë..!

DASHURI dhe JETË, dy koncepte të ndërlidhura njëra me tjetrën, ku pa dashuri s'ka jetë dhe pa jetë, nuk ka dashuri”.



Maxhar Turizam



NISJET:

TËRNOC - PRISHTINË : 6,30 ; 11,30
 TËRNOC - GJILAN: 5,20 ; 07,30 ; 09,00; 13,00 ; 13,40; 17,00
 TËRNOC - MUHOC : 09,30; 15,00 ; 17,00
 TËRNOC - PRESHEVË: 08,00 ; 11,00 ; 14,00 ; 16,30

(Për nxënës deri në Bilaç 19,30, deri në Breznicë 17,30)

KTHIMI:

PRISHTINË - TËRNOC : 11,05 ; 15,50
 GJILAN - TËRNOC : 07,10; 09,00; 11,00; 12,15;
 14,45; 15,35; 17,15 ; 18,30
 MUHOC - TËRNOC: 07,30 ; 11, 30; 17,00
 PRESHEVË - TËRNOC: 09,15 ; 12,30 ; 15,15; 18,30

(Për Bilaç për nxënës 07,15)

Nisjet nga Rainca :

Raincë Tërnoc: 06,50; 09,00; 12,20; 14,40; 17,00; 18,45

Nisjet nga Tërnoci:

Tërnoc Raincë : 07,30; 11,10; 13,20 Bujanoc 13,45;
 15,30; 17,50; 19,30

PRISHTINË - LIPJAN - SHTIME - FERIZAJ - VITI - GJILAN -
 07,00 07,15 07,30 08,00 8,20 09,00
 - PRESHEVË - BUJANOC - VIENA - MUNICH
 11,00 11,30 50 € 60 €

St.GALLEN - ZURICH - BASEL - BERN - LAUSANNE - GENEVA.
 150 € 150 € 150 € 150 € 180 € 200 €

NISJET PREJ ZVICRES



GENEVA - LAUSANNE- BERN - BASEL - ZURICH -
 - ST.GALLEN-MUNICH-VIENA-BUJANOC-PRESHEVË-
 - GJILAN-VITI-FERIZAJ-SHTIME-LIPJAN-PRISHTINË

REZERVIMET PËR PENSIONER
 DHE STUDENTËT ME NGA 10% LIRIM

BIPBM

Organizon

Haxhin 2015 / 1436



Me 3200 Euro, janë përfshirë të gjitha shpenzimet e nevojshme lidhur me Haxhin

Informata në tel. 063/8933722, 063/1571440



 **FABRIKA PËR** 
PËRPUNIMIN E MISHIT
AGRO-ADRIA

KOMPANIA PËR
NDËRTIME TË LARTA



+381 (0) 63 402 262
+381 (0) 62 428 021

www.agro-adria.com

KOMPLEKSI AFARIST - BANESOR
AGRO-ADRIA

